

## **Gent Ibrahimi**

Z. Gent Ibrahimi është Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë që prej vitit 2018. Përpara marrjes së kësaj detyre në krye të institucionit që administron karrierën e prokurorëve, Z. Ibrahimi ka drejtuar për pothuajse 19 vjet (me disa shkëputje) Institutin për Studime Publike & Ligjore, një organizatë e shoqërisë civile me orientim kërkimor/shkencor në fushën e qeverisjes dhe sistemit të drejtësisë. Në këtë cilësi ai është shquar si ekspert me kontribute të spikatura në fusha që kanë të bëjnë me reformat në sektorin publik, sistemin e drejtësisë, parandalimin e korrupsionit dhe lirinë e shprehjes. Gjatë gjithë këtyre viteve ai është angazhuar sistematikisht në mësimdhënie dhe trainime në Shkollën e Magjistraturës.

Në vitet 2014 – 2016 Z. Ibrahimi shërbeu si ekspert i nivelit të lartë në grupin e ngushtë të ekspertëve të angazhuar nga Komisioni Parlamentar Ad Hoc për Reformën në sistemin e Drejtësisë.

Në vitet 2008 – 2013 Z. Ibrahimi ka shërbyer si anëtar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (organi pararendës i Autoritetit të Mediave Audiovizuale të sotëm).

Në vitet 1998 – 1999 ka shërbyer si Këshilltar dhe Drejtor Kabineti i Ministrit për Reformën Legjislative dhe Marrdhëniet me Kuvendin i ngarkuar me detyrën e koordinimit të procesit të hartimit dhe miratimit të Kushtetutës të vitit 1998 dhe paketës legjislative post kushtetuese.

Më herët (në vitet 1993 – 1998) Z. Ibrahimi ka punuar si pedagog i së drejtës administrative në fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës dhe si specialist pranë Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.